



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1157/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmanit kryesues, Ymer Hoxha dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Makfirete Ademi kandidate për asamble komunale në Vushtrri nga rradhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), paraqitur kundër komisionarëve të vendvotimit 2711b pas shpalljes së rezultateve perfundimtare për kuvend komunal nga KQZ-ja për shkak të mungesave të votave për zgjedhjet lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Makfirete Ademit kandidate për kuvendin komunal të Vushtrrise nga rradhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Vushtrri

Arsyetim

PZAP-i , më datën 03.12.2013, ka pranuar një ankesë nga Makfirete Ademi kandidate për asamble komunale në Vushtrri nga rradhët e AAK-së me dyshimin se në vendvotimin 2711b i mungojnë votat të cilat i janë dhënë nga familjarët, andaj parashtresja e ankesës thekson se ka shumë pakënaqësi me këtë vendvotim.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore nga ana e Makfirete Ademi se i mungojnë votat e dhëna nga familjarët e saj, PZAP-i këto pretendime i konsideron si të pabaza në prova dhe në dëshmi bindëse pasi që ankuesi ankesës në fjalë nuk i ka bashkangjitur asnjë provë që do të bënin të besueshme pretendimet e saja të parashtuara në ankesë. Andaj

PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 1157/2013 më datën 06.12.2013.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.